

Në bazë të nenit 27 paragrafi 2 të Ligjit për veprimtarinë e inovacionit (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/13, 137/13, 41/14,6/16, 53/16,190/16 dhe 64/18), Bordi drejtues i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, në seancën e mbajtur më 20.01.2020 solli:

RREGULLAT

për organizimin dhe zbatimin e garave dhe sfidave për inkurajimin e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë

Me këto rregulla përcaktohen karakteristikat e garave dhe sfidave për inkurajimin e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë (në tekstin e mëtutjeshëm). Rregullat e garave dhe sfidat) kriteret dhe procedurat për aplikim në gara dhe sfidat e organizuara nga ana e Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi).

Me rregullat për gara dhe sfidat rregullohen edhe:

- kriteret dhe kushtet për ndarjen e çmimeve të dedikuara për gara dhe sfida të organizuara nga ana e Fondit;
- -procedurat për ndarjen e mjeteve për çmime të dedikuara për gara dhe sfida të organizuara nga ana e Fondit;
- -rregullat për pagesën e mjeteve për çmime;
- -rregulla për zbatimin e projekteve të mbështetura përmes garave ose sfidave të organizuara nga ana e Fondit;
- rregullat për mbikëqyrje, ndjekje dhe evalvim;
- -kushtet për ndërprerje të përkohshme dhe ndalim të financimit;
- mekanizmat për mbrojtjen e mjeteve të ndara përmes garave ose sfidave dhe
- -çështje tjera nga puna e Fondit.

Garat dhe sfidat Fondi mund t'i organizojë dhe zbatojë në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me organizatat tjera.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizime

1. “ Garues” do të thotë subjekt juridik i cili deri te Fondi ka parashtruar propozim projekt në thirrjen e hapur publike për ndarjen e çmimeve për gara dhe sfida të organizuara nga ana e Fondit (në tekstin e mëtutjeshëm: gara dhe sfida).
2. “ Marrëveshje për ndarjen e çmimeve” do të thotë marrëveshje lidhur ndërmjet Fondit dhe garuesit ë përzgjedhur, për ndarjen e mjeteve, i cili është në pajtim me rregullat dhe procedurat e shënuara në Rregullat për organizimin dhe zbatimin e garave dhe sfidave të organizuara nga ana e Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik.
3. “ Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje” do të thotë Komisioni i përbërë nga përfaqësues nga organizatori, organizatat partnere dhe ekspert të jashtëm nga fusha për të cilën

organizohet gara përkatësisht sfida, ndërsa e cila kryen aktivitete në përputhje me Rregullat për gara dhe sfida.

4. “ Shfrytëzuesi i çmimit” do të thotë subjekt juridik i cili me Fondin ka firmosur Marrëveshje për ndarjen e çmimeve në gara ose sfida.
5. “ Çmim” do të thotë grand në lloj të ndihmës në të holla dhe / ose ndihmë teknike të ndarë nga ana e Fondit për shfrytëzuesin e caktuar të çmimit për financimin e punëve, prokurimin e mallrave, shërbimeve konsultative dhe të tjera në përputhje me aplikacionin projektues të miratuar dhe buxhetin e projektit bashkë financiar nga ana e shfrytëzuesit të çmimit në përputhje me kushtet e shënuara në Rregullat për gara dhe sfida dhe në përputhje me kushtet e shënuara të thirrjes publike.
6. “ Propozim projekt” do të thotë projekt i parashtruar në thirrjen e hapur publike për ndarjen e çmimeve në kuadër të garës së caktuar përkatësisht sfidës së Fondit i cili financohet përmes bashkëfinancimit grant në përputhje me kriteret dhe procedurat e shënuara në Rregullat për gara dhe sfida.
7. “ Thirrje e hapur” është thirrje për dorëzimin e propozim – projektit shpallur në media i cili i përmban kushtet për pjesëmarrje, afati për aplikim si dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim në gara përkatësisht sfida të organizuara nga ana e Fondit, ndërsa në përputhje me kushtet e shënuara në Rregullat për gara dhe sfida.

II. KARAKTERISTIKA E PËRGJITHSHME

Qëllimet e përgjithshme të garave dhe sfidave

Qëllimet e përgjithshme të garave dhe sfidave të organizuara dhe zbatuara nga ana e Fondit janë:

- Inkurajimi i inovacionit dhe frymës sipërmarrëse, sipërmarrjet e vogla dhe të mesme duke hartuar zgjidhje të reja për problemet me të cilat ballafaqohen bashkësitë, si mundësinë për zhvillimin e bizneseve të reja përmes zbatimit të zgjidhjeve;
- Zhvillimi i prodhimeve, shërbimeve, proceseve, aktiviteteve ose metodologjive inovative që ofrojnë zgjidhje praktike të dobishme dhe shoqërore për çështje të caktuara ose probleme në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë; dhe
- Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat nga njëra anë dhe institucioneve të larta arsimore dhe shkencore, sipërmarrjeve, shoqatave të qytetarëve si dhe format tjera të bashkëpunimit nga ana tjetër.

Grupi qëllimor

Garat dhe sfidat janë të dedikuara për të inkurajuar aktivitetin inovativ tek format e ndryshme të subjekteve juridike si sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, shoqatat, institucionet e arsimit të lartë dhe personat e tjerë juridikë që dëshirojnë të kryejnë veprimtari kërkimore dhe zhvillimore dhe / ose të zhvillojnë një produkt, shërbim, proces, veprimtari ose metodologji inovative, vetëm ose në bashkëpunim me një person tjetër juridik.

Çmimet

Përmes garave dhe sfidave, Fondi siguron çmime si një grant në formën e ndihmës financiare dhe / ose ndihmës teknike.

Lartësia dhe shuma e saktë e çmimeve rregullohet me Thirrjen publike për pjesëmarrje në garë / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën e garës / sfidës.

Me Thirrjen publike mund të caktohet edhe përqindja e pjesëmarrjes së garuesit përkatësisht shfrytëzuesit të çmimit në buxhetin e përgjithshëm.

Mjetet e fituara nga Fondi mbi ndonjë bazë tjetër ose ndonjë ndihmë tjetër shtetërore nuk do të konsiderohen të pranueshme për bashkëfinancim nga ana e garuesit.

Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e projektit për të cilin janë ndarë mjete përmes garave ose sfidave mund të jetë deri në 24 (njëzet e katër) muaj.

Fondi, në bazë të rrethanave të justifikuar, mund të miratojë zgjatje të zbatimit të projektit deri në gjashtë muaj.

Në rast të zgjatjes së kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, shuma e ndarë e grantit nuk mund të rritet.

III. KRITERET PËR PËRSHTATJEN E GARUESVE

Propozim – projektet mund të parashtrohen nga garues individual.

Kriter i përgjithshëm për përshtatshmëri që një garues duhet të plotësojë është:

- Të jetë person juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe
- Të jetë në pronësi dominuese të shtetasve maqedonas, në rast kur ajo është e përcaktuar në vetë Thirrjen publike.

Në rast të një subjekti juridik të themeluar në përputhje me Ligjin për shoqatat tregtare të jetë një sipërmarrje mikro, e vogël ose e mesme që nuk është në vështirësi (sipërmarrje në vështirësi është një sipërmarrje që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj nga burimet e veta ose me mjetet që mund t'i marrë ato nga pronari / aksionarët ose kreditorët e saj, për të ndaluar humbjet, të cilët pa ndërhyrje të jashtme nga ofruesit e ndihmës me siguri do të çojë në përfundimin afatshkurtër dhe afatgjatë të funksionimit të sipërmarrjes.).

Garuesi individual propozim-e projektin mund të paraqesë në partneritet ose konsorcium, nëse kjo mundësi rregullohet në Thirrjen publike.

Kriteret e veçanta për përshtatshmërinë e garuesve, si dhe anëtarët e partneritetit dhe konsorciumit (nëse është e zbatueshme), rregullohen në vetë Thirrjen e hapur publike për pjesëmarrje në garë / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën e garës/ sfidës.

Destinimi i mjeteve

Mjetet e fituara nga Fondi duhet të destinohen për aktivitetet të destinuara për zhvillimin dhe zbatimin e inovacionit të propozuar si

- aktivitetet për hulumtim dhe zhvillim;
- aktivitetet e testimit;
- aktivitetet në lidhje me mbrojtjen e pronës intelektuale;
- dizajni;
- zhvillimi i linjave pilot;
- aktivitetet në lidhje me sigurimin e cilësisë, standardizimin dhe akreditimin dhe
- aktivitetet e marketingut dhe shitjeve (që synojnë sjelljen e inovacionit në gatishmërinë dhe pjekurinë e investimeve për futjen në treg).

Lista e mësipërme e aktiviteteve nuk është e kufizuar, aktivitetet specifike të cilat mund të jenë subjekt i financimit rregullohen në Thirrjen publike për pjesëmarrje në garë / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën e garës / sfidës.

Shpenzimet e pranueshme për financim

Shpenzimet e pranueshme për financim në kuadër të propozim – projektit të parashtruar në garë ose sfidë janë:

- pagat bruto - shumat e pagave bruto për punonjësit e angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikën e vendosura të shfrytëzuesit të çmimit para fillimit të projektit;
- prokurimi dhe / ose marrja me qira e pajisjeve dhe materialeve të konsumit për kërkim dhe zhvillim;
- angazhimi i ekspertëve/këshilltarëve për kërkim dhe zhvillim;
- angazhimi i konsulentëve për nevoja të tjera të lidhura drejtpërdrejt me rezultatet e pritura të sfidës (ekspertizë në lidhje me menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar, mobilizimin e burimeve shtesë financiare, zhvillimin e biznesit, marketingun, çështjet juridike, mbrojtjen e pronës intelektuale, etj.);
- sigurimi i cilësisë, standardizimi dhe akreditimi;
- mbështetje për zyrë dhe mbështetje afariste (marrjen me qira të hapësirave afariste, shpenzime të regjisë, tarifa bankare, shërbimet e kontabilitetit etj.);
- shpenzimet për promovimin e rezultateve të / nga projekti;
- shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e akomodimit, tarifat e regjistrimit dhe mëditjet në lidhje me qëllimet e garës / sfidës; dhe
- shpenzimet administrative (tarifat bankare, dorëzimi i një llogarie vjetore për llogarinë e destinimit të projektit, shpenzimet për publikimin e thirrjes për prokurimi publik).

Shpenzimet specifike të lejuara për financim rregullohen në thirrjen publike për pjesëmarrje në garë / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën e garës/ sfidës.

Shpenzime jo të papranueshme për financim

Shpenzimet e papranueshme për financim në kuadër të propozim-projektit të parashtruara për garë përkatësisht sfide janë:

- pagesa e interesit ose borxhit të palës tjetër;
- shpenzimet dhe provizionet nga humbjet ose detyrimet nga e kaluara ose në të ardhmen;
- mbulimi i humbjeve për shkak të ndryshimit të valutës, taksave dhe dënimeve;
- shpenzimet për ahengje dhe reprezentacion;
- shpenzimet për rekrutim të kuadrit (shpenzimet për shpalljen e thirrjeve publike , provizionet nga agjencitë për punësim, shpenzimet që kanë të bëjnë me seleksionimin e kandidatëve dhe të njëjtat) dhe shpenzimet për shpërngulje;
- blerja e tokës ose ndërtesave, përfshirë edhe renovimin;
- pagesa në të holla nga xhiro-llogari e veçantë të projektit;
- aktivitet për eksport (shpenzimet direkt të lidhura me eksportin e produkteve, me themelimin dhe funksionimin e rrjetit për shpërndarje dhe të njëjtë;
- taksa vjetore për mirëmbajtje të patentës (me përjashtim të rasteve të arsyetuara mirë të vlerësuara si shpenzim i lejuar pranë evalvimit të propozim projekteve;
- shtesat e rrogës;
- shpenzimet për shërbime këshillimi të siguruara nga ana e pronarit/ve të ndërmarrjes e cila është shfrytëzues e shpërblimit;
- huazimi për hapësirën e punës nga qiradhënësi i cili merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është person i cili është i lidhur me shfrytëzuesin e shpërblimit;
- furnizimi me automjete për udhëtarë, ngarkesa dhe transport;
- furnizimi me pajisje të shfrytëzuara dhe
- tatimi i vlerës së shtuar (TVSH), në raste kur subjekti i shpërblyer ka të drejtë të kthejë TVSH-në.

Nuk janë të pranueshme për financim dhe shpenzime për realizimin e aktiviteteve të cilat paraprakisht kanë qenë të financuara nga burime tjera.

Të drejtat e pronësisë intelektuale

Në rast se projekti bazohet në të drejtat ekzistuese të pronës intelektuale, garuesi është i detyruar së bashku me propozim - projektin të dorëzojnë dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit të pronës intelektuale në formën e një marrëveshje licencimi, marrëveshje për kontribut „in-kind“ ose lloj tjetër marrëveshje që konfirmon se garuesi ka të drejtë të përdorë pronësinë intelektuale mbi të cilën bazohen rezultatet e projektit.

Garuesi nuk duhet të shkelë me dashje ose qëllimisht të drejtat e pronës intelektuale të ndonjë pale të tretë.

Fondi nuk do të jetë përgjegjës për kontestet mbi të drejtat e pronës intelektuale midis garuesit / shfrytëzuesit të çmimit dhe palëve të treta.

Sipas nevojës detyrimi për të mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale dhe detyrimi për të transferuar të drejtën e shfrytëzimit të pronës intelektuale rregullohen në Thirrjen publike për pjesëmarrje në një garë / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën e garës / sfidës.

Mbrojtja e mjedisit jetësor

Çdo propozim-projekt i dorëzuar në Thirrjen publike për ndarjen e mjeteve të Fondit që ka ndikim në mjedisin jetësor duhet të jetë në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor dhe ligjet tjera relevante përkatëse dhe aktet nënligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

IV. PROCESI I APLIKIMIT DHE PROCEDURA PËR NDARJEN E ÇMIMEVE

Thirrje Publike

Mjetet financiare për garat ose sfidat ndahen në bazë kompetitive pas shpalljes së Thirrjes publike i cili paraprakisht është sjellë nga Bordi drejtues i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

Thirrja publike duhet të publikohet në të paktën dy media publike dhe në ueb faqen e internetit të Fondit.

Afati për dorëzimin e propozim-projekteve do të përcaktohet deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

Thirrja publike detyrimisht duhet të përmbajë informacionet në vazhdim:

- datën e shpalljes së Thirrjes publike;
- përshkrimin qëllimeve të garës ose sfidës;
- shumën e çmimit përkatësisht bashkëfinancimit (nëse është e zbatueshme)
- kriteret për pranimin e garuesve;
- listën e aktiviteteve dhe shpenzimet e pranueshme për financim;
- kriteret për vlerësim dhe përzgjedhje;
- përbërjen e Komisionit për vlerësim dhe përzgjedhje;
- mënyrën e parashtrimit së dokumentacionit të nevojshëm;
- formularët në të cilët duhet të plotësohet propozim-projekti;
- afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe
- kontakt informacione.

Të gjitha të dhënat e lartshënuara duhet të përfshihen në Thirrjen e plotë publike të shpallur në ueb faqen e Fondit. Për Thirrjen publike të shpallur në media duhet të përgatitet version i shkurtuar.

Dokumentacioni i nevojshëm

Gjatë aplikimit në garë ose sfidë duhet të dorëzohen dokumentet në vazhdim:

1. Formular i plotësuar në rregull për aplikim për Projekt
2. Formular i plotësuar në rregull për Buxhetin e Projektit dhe

3. Dokumentacion shtesë në lidhje me garuesin , i cili do të specifikohet në detaje në Thirrjen publike.

Dokumentacioni i projektit duhet të dorëzohet në formularët e përgatitur nga Fondi.

Dokumente shtesë në rast të ndarjes së çmimit

Në rast se garuesit i jepet një çmim, garuesi në Fond duhet gjithashtu të dorëzojë edhe :

- marrëveshjet me palët e treta në lidhje me zbatimin e projektit (nëse është e zbatueshme);
- në rast se projekti bazohet në të drejtat ekzistuese të pronësisë intelektuale, garuesi është i detyruar të dorëzojë dëshmi të së drejtës për shfrytëzimin e pronës intelektuale pronësia në formën e një marrëveshje licencimi, marrëveshje kontributi „in-kind“ ose lloj tjetër marrëveshje që konfirmon se garuesi ka të drejtë të shfrytëzojë pronësinë intelektuale në të cilën bazohen rezultatet e projektit dhe
- të dhëna nga një llogari e hapur bankare speciale për nevojat e projektit.

Fondi rezervon të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga garuesit , të cilët janë të detyruar ta dorëzojnë atë në afat sa më të shkurtër kohorë.

Sesione informimi dhe konsultimi

Gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike, Fondi mund të organizojë informacione-ngjarje, trajnime, sesione konsultimi dhe mentorimi ku garuesit e mundshëm do të kenë mundësinë të marrin informacion shtesë dhe ndihmë profesionale në përgatitjen e propozim- projekteve.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së sesioneve informative dhe mentoruese garuesit do të njoftohen në kohë përmes medieve dhe / ose formës elektronike (medieve elektronike dhe /ose e – mail)

V. PROCESI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje

Vlerësimi, përzgjedhja dhe vendimi për ndarjen e çmimeve, përkatësisht financimi i projekteve është nën kompetencën e vetme të Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhje e një gare ose sfide (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje).

Komisioni i Vlerësimit dhe Përzgjedhjes përcaktohet në Thirrjen Publike dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët:

- Një anëtar është përfaqësues i Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik;
- Të paktën një ekspert në fushën specifike të garës / sfidës, dhe
- Të paktën një ekspert në fushën e zhvillimit të biznesit (nëse është i zbatueshëm)

Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes

Vlerësimi i projektit përbëhet nga disa hapa:

- **Kontrolli administrativ i dokumentacionit të dorëzuar** (nëse dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me kushtet e pranueshmërisë së cekura në Thirrjen publike);
- **Vlerësimi i parë i propozim - projektit** (para - selektimit) dhe
- **Përzgjedhja e projekt -propozimeve** më të mira (përfshirë prezantimin e propozimeve të para-selektuara të projektit para Komisionit për Vlerësim dhe përzgjedhje).

Verifikimi administrativ i dokumenteve të dorëzuara

Verifikimi administrativ i dokumenteve të dorëzuara kryhet nga persona të punësuar në Fondin për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik të autorizuar nga drejtori.

Në rast se vërtetohet se një pjesë e dokumentacionit në lidhje me garuesin mungon,garuesi ka të drejtë ta plotësojë atë brenda një afati të përcaktuar nga Fondi.

Nëse garuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në Thirrjen publike, konsiderohet jo i plotë.

Nga verifikimi administrativ i dokumenteve të dorëzuara përpilohet procesverbal.

Pas përfundimit të verifikimi administrativ, çdo dokumentacion i plotë u dorëzohet anëtarëve të Komisionit për Vlerësim dhe Përzgjedhje.

Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes

Kriteret për vlerësim dhe numri i pikëve për zgjedhjen e propozim –projekteve rregullohen në thirrjen publike për pjesëmarrje në gara / sfidë në përputhje me qëllimet dhe fushën gara / sfida.

Anëtarët e Komisionit për vlerësim dhe zgjedhje i vlerësojnë projekt propozimet sipas kriterëve të vërtetuara. Secili projekt propozim që do të marrë së paku 51% të numrit të përgjithshëm të pikëve kalon në fazën e selektimit.

Pikat përfundimtare, në lidhje të kriterëve për vlerësim, anëtarët e Komisionit për Vlerësim dhe Përzgjedhje i japin në fazën e selektimit, pas prezantimit të projekt propozimeve nga ana e konkurrentëve të paraselektuar.

Për fazën e selektimit, Komisioni për Vlerësim dhe Përzgjedhjes përpilon Procesverbal.

Të shpërblyer do të jenë ato propozim projekte që kanë numrin më të lartë të pikëve pas përfundimit në fazën e selektimit. Gjatë zgjedhjes së projekteve të shpërblyera, gjithashtu do të merret parasysh shumica e mjeteve financiare në dispozicion nën thirrjen publike.

Fondi e mbanë të drejtën për të negociuar me konkurrentët në lidhje me përcaktimin e aktiviteteve të projektit dhe buxhetit bazuar në rekomandimet e fituara nga Komisioni i Vlerësimit dhe zgjedhjes, para nënshkrimit të Marrëveshjes për ndarjen e shpërblimit, nëse kjo dispozitë është e deklaruar në thirrjen publike. Fondi mbanë të drejtën të mos ndajë shpërblim nëse nuk ka mjaft

cilësi të propozim -projektit ose nuk janë plotësuar kushtet për ndarjen e çmimit në përputhje me këto Rregulla dhe kushtet e shënuara në Thirrjen Publike.

Afatet për aplikim, para selektimit, selektimi dhe miratimi i vendimit për ndarjen e çmimeve do të përcaktohen në korniza të thirrjes publike. Fondi mban të drejtën për ndryshimin e këtyre afateve.

VI. ZBATIMI I PROJEKTEVE

Elementet e kontratës për ndarjen e çmimit

(1) Garuesit për të cilët është marrë vendim për ndarjen e çmimit do të ftohen të nënshkruajnë Kontratë për ndarjen e çmimit në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e miratimit të Vendimit.

(2) Elementet e obliguara të kontratës për ndarjen e çmimit janë:

- palët e marrëveshjes;
- lënda e marrëveshjes;
- përkufizimet dhe interpretimet;
- vlera e kontratës;
- kohëzgjatja e projektit;
- të drejtat dhe obligimet e Fondit dhe shfrytëzuesit të çmimit;
- fuqi e lartë;
- ndërprerja e kontratës;
- -dispozitat përfundimtare dhe
- aplikimi i projektit dhe buxheti i projektit

Pagesa e mjeteve

Pagesa e mjeteve bëhet në llogari bankare të veçantë e dedikuar për nevojat e projektit.

Mjetet paguhen paraprakisht, në baza tremujore, në përputhje me Buxhetin e Projektit, përveç nëse specifikohet ndryshe në thirrjen publike.

Në rast të pagesave tremujore, mjetet financiare për çdo këst pasues do të paguhen në llogarinë speciale pasi të jenë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- raporti i miratuar tremujor për përparim (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare), përveç nëse ërcaktohet ndryshe në thirrjen publike;
- me qëllim të shpenzuara së paku 70% (shtatëdhjetë përqind) nga buxheti i mëparshëm, mjetet dhe
- dëshmi të dorëzuar për pagesën e bërë në kofinancimin e pronësisë për tremujorin e ardhshëm në formën e deklaratës bankare (nëse është e zbatueshme).

Nëse në Thirrjen Publike është paraparë kofinancim nga ana e shfrytëzuesit të çmimit, mjetet për këstin e parë do të paguhen në llogarinë speciale të projektit pas nënshkrimit të

Marrëveshjes për ndarjen e çmimit, pasi shfrytëzuesi çmimit do të dorëzojë te Fondi dëshmi për pagesë e kryer të kofinancimit të pronësisë për tremujorin e parë në formën e deklaratës bankare.

Për të gjitha çmimet që tejkalojnë 300,000 denarë, Fondi nga pagesa e fundit mban 5% nga shumata e përgjithshme e çmimit e ndarë nga Fondi . Kjo shumë i paguhet shfrytëzuesit të çmimit me miratimin e Raportit Përfundimtar të Projektit.

Ndihma teknike për shfrytëzuesit e çmimit

Për kohëzgjatjen e projektit, Fondi mund të sigurojë trajnime shtesë, konsultative dhe seanca mentoruese për shfrytëzuesit e çmimit me qëllim zbatim më të suksesshëm të projektit.

Obligimet e shfrytëzuesit të çmimit

Shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të zbatojë projektin në përputhje me kushtet të përshkuara në Thirrjen Publike, Rregullat për garat dhe Sfida dhe Marrëveshjen e ndarjes së çmimit si dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e mira teknike, ekonomike, financiare, menaxhuese, ekologjike dhe standarde sociale dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar të zbatojë projektin në mënyrë efektive dhe efikase, në përputhje me aplikimin e projektit dhe buxhetin e projektit.

Shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar të mbajë sistem për menaxhimin financiar dhe të mbajë sistem të evidencës së ndarë-të veçantë financiare-të kontabilitetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në mënyrën më të përshtatshme për aktivitetet e projektit, burimet e disponueshme dhe shpenzimet në lidhje me projektin dhe do të përgatisë raporte financiare në përputhje me kontabilitetin në bazë të parave gjegjësisht të para në dorë, duke paraqitur qartë faturat dhe pagesat për tremujorin të cilave u referohen,, në mënyrë që do të korrespondojë me aktivitetet burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin.

Fondi do të kërkojë nga shfrytëzuesi i çmimit , si dhe nga furnizuesit e zgjedhur, konsulentët dhe pjesëmarrësit në projektin t'i përmbahen standardeve më të larta etike në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe dukuritë e ndërlydhura gjatë zbatimit të kontratës.

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

Çdo prokurim i mallrave dhe shërbimeve shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar të bëjë në përputhje me praktikën e pranueshme komerciale:

- Gjatë zbatimit të prokurimeve të parashikuara në projektin, shfrytëzuesit duhet të marrin parasysh nevojën ekonomike, efikasitetin, transparencën dhe kohëzgjatjen e procedurës së prokurimit, si dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të prokuruar.

- Për prokurimet që tejkalojnë 300,000.00 (treqind mijë) denarë, shfrytëzuesi i çmimit duhet të zbatojë procedurë me grumbullimin e minimum tre ofertave. Shfrytëzuesi i çmimit te Fondi duhet të dorëzojë për miratim, dokumentacionin për secilën fazë nga procedura e tenderit.(p.sh. shpalljen

publike, kriteret e zgjedhjes, kontratën, etj.). Në raste të arsyeshme mirë, këto prokurime mund të zbatohen pa procedurë të tenderit pas miratimit paraprak nga Fondi. Në rastet kur sigurohen mjetet nga organizata ndërkombëtare (donatorë dhe huadhënës) ose nga vende të treta, ndërsa nga ana tjetër janë përcaktuar kushte të veçanta për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar t'i marrë parasysh gjatë zbatimit të prokurimeve.

Kur është e zbatueshme, marrëveshjet midis shfrytëzuesit të çmimit dhe palëve të treta duhet të përfshijnë dispozita në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, parandalimin e konfliktit të interesit, revizioni dhe ndikimi mbi mjedisin jetësor.

Rregullat për dukshmërinë e donatorit

Gjatë kohës së zbatimit të projektit, shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar të gjithë materialet promovuese për projektin t'i shënojë me logon dhe titullin e Fondit dhe të theksojë qartë se projekti zbatohet me mbështetjen e Fondit.

Pajisja e prokurimit përmes projektit financiar nga Fondi detyrimisht duhet qartë të shënohet me logon e Fondit, si dhe me rikujtuese: "Mbështetur nga Fondi i Inovacionit dhe zhvillimi teknologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut". Në rastet kur për financimin e projektit janë siguruar mjetet edhe nga organizatat ndërkombëtare (donatorë dhe huadhënës) ose nga vende të treta, shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar t'i marrë parasysh rregullat e për dukshmërinë e së njëjtës.

Nëse shfrytëzuesi i çmimit posedon ueb faqe, është i detyruar të publikojë informacion të shkurtër në lidhje me mbështetjen e siguruar nga Fondi. Nëse shfrytëzuesi i çmimit publikon ose jep deklaratë për medie në lidhje me projektin, është i detyruar ta përmend mbështetjen e siguruar nga Fondi.

Ndryshime në projektin

Çdo ndryshim në projektin duhet të jetë i arsyetuar dhenë drejtim për të arritur rezultatet e pritura të projektit.

Çdo devijim i rëndësishëm nga aplikimi i projektit dhe buxheti i projektit (ndryshime në planin e aktiviteteve, ndryshime në rezultatet e pritshme të projektit, ndryshim në njerëzit kryesorë të projektit, etj.) duhet të miratohet paraprakisht nga Fondi.

Shfrytëzuesi i çmimit ka të drejtë në konvertimin e mjeteve e cila tejkalon prej 10% (dhjetë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit, për tërë kohëzgjatjen e projektit në drejtim që të arrihen rezultatet e pritura të projektit. Për konvertimin shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar ta informojë Fondin në korniza të raporteve tremujore dhe raportit përfundimtar.

Çdo konvertim i mjeteve që tejkalon 10% (dhjetë përqind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit duhet të miratohet paraprakisht nga Fondi.

Fondi ka për qëllim të inkurajojë veprimin inovativ dhe marrjen përsipër në rrezik. Për arsye që projektet inovative shpesh zhvillohen ndryshe nga pritjet fillestare, ky faktor do të merret parasysh gjatë miratimit të vendimeve të ndryshimeve në projektin.

Ruajtja e dokumentacionit

Shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të ruaj të gjithë dokumentacionin e projektit nga fillimi i zbatimit të projektit.

Dokumentacioni i detyruar i projektit përmban:

- tërë dokumentacionin që është dorëzuar gjatë paraqitjes në garën, përkatësisht sfidën;
- të gjitha dokumentet zyrtare të komunikimit ndërmjet shfrytëzuesit të çmimit dhe Fondit gjatë periudhës së aplikimit për gara, gjegjësisht sfidës;
- Kontrata për ndarje të çmimit ;
- të gjitha dokumentet zyrtare në periudhën e zbatimit të projektit;
- ekzemplarë origjinale të të gjitha raporteve të paraqitura në Fond;
- njoftimet për miratimin e raporteve të dorëzuara nga Fondi;
- ekzemplarë origjinal nga të gjitha faturat dhe
- të gjitha dokumentet e tjera, përfshirë edhe marrëveshjet me palët e treta, dhe dëshmi të tjera të pagesës në lidhje me projektin.

Shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar ta ruajë dokumentacionin e mësipërm në afat së paku 5 vjet pas përfundimit të projektit.

VII. Vëzhgimi, ndjekja dhe vlerësimi i rezultateve të projektit

Mënyrat e zbatimit të mbikëqyrjes

Fondi kryen mbikëqyrje të projektit përmes rishikimit të raporteve të dorëzuara nga shfrytëzuesi i çmimit, përmes zbatimit të vizitave në terren dhe / ose përmes vlerësimit të rezultatet e projektit.

Qëllimet e mbikëqyrjes

Qëllimi i mbikëqyrjes është të ndjek progresin e projektit dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, për të konfirmuar se shpenzimet e realizuara janë në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit për periudhën e dhënë dhe në përputhje me procedurat e Fondit, si dhe të vlerësohen rezultatet pas përfundimit të projektit.

Metodat e mbikëqyrjes përfshijnë:

- rishikimin dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga shfrytëzuesi i çmimit dhe
- vizitat në terren te shfrytëzuesit dhe partnerët (nëse është e zbatueshme) në projekt.

Mbikëqyrjen e kryejnë ekipet për ndjekje të caktuar nga Drejtori i Fondit..

Raportet që i dorëzon shfrytëzuesi i çmimit

Shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të paraqesë raporte në Fond, si më poshtë:

- Raport tremujor për progres (pjesa përshkuese dhe pjesa financiare) që shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar t'i dorëzojë për kohëzgjatjen e projektit dhe atë në afat prej 14(katërbëdhjetë) ditësh pas skadimit të tremujorit, (nëse është e zbatueshme) dhe
- Raporti përfundimtar (pjesa përshkuese dhe pjesa financiare) cili shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar ta dorëzojë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas skadimit të ditës së fundit kalendarike nga projekti.

Raportet plotësohen në formularët e vërtetuar nga Fondi.

Raportet shqyrtohen nga ekipet për ndjekje të caktuar nga Drejtori i Fondit. Në rast të parregullsive të identifikuara në njoftimin që mund të korrigojen nga shfrytëzuesi i çmimit, Fondi e njofton shfrytëzuesin për parregullsitë e identifikuara me kërkesë për të eliminuar parregullsitë dhe për të paraqitur raport të rishikuar.

Në rast se raporti është përkatësisht i plotësuar dhe i dorëzuar, Drejtori i Fondit, me rekomandimin e ekipeve për ndjekje, e miraton raportin dhe miratimin e dorëzon te shfrytëzuesit i çmimit.

Ekipi për ndjekje ka të drejtë nga shfrytëzuesi i çmimit të kërkojë informacione shtesë dhe dokumente në lidhje me raportet si dhe të kryejë vizitë në terren të pa lajmëruar të shfrytëzuesit me qëllim që të kontrollojë informacionet e dorëzuara në raportet.

Vizitat në terren

Ekipet për ndjekje detyrimisht zbatojnë të paktën një vizitë në terren për çdo projekt në afat prej 12 muajve. Fondi ka të drejtë të zbatojë edhe më shumë vizita në terren nëse është e nevojshme.

Vizitat në terren përfshijnë vizitë të shfrytëzuesit të çmimit dhe takim me njerëzit kryesorë të projektit me qëllim mbikëqyrje mbi zbatimin e projektit (p.sh. përmbajtjen në procedurat, arritja e rezultateve të parashikuara, përmbajtja e kornizës kohore, përmbajtja e dispozitave të marrëveshjes për ndarjen e mjeteve, etj.)

Vizita në terren mund të lajmërohet ose të mos lajmërohet. Gjatë vizitës së njoftuar në terren, ekipi për ndjekje dërgon te shfrytëzuesi i çmimit njoftim për zbatimin e vizitës në terren i cili përmban detaje në lidhje me vendndodhjen, kohën e vizitës, personat që duhet të jenë të pranishëm, dokumentacioni dhe pajisjet e prokuruar që duhet të jenë në dispozicion për mbikëqyrje. Njoftimi i zbatimit të vizitës në terren dorëzohet së paku 7 (shtatë) ditë para zbatimit të vizitës.

Për vizitën e kryer në terren, ekipi për ndjekje përpilon procesverbal në të cilin futet rrjedha e vizitës personat që morën pjesë në vizitën në terren, dokumentacioni që është i kontrolluar, vërejtjet e konstatuara nga ekipi, identifikimi i parregullsisë, udhëzimet dhe afatet për eliminimin e çdo parregullsie eventuale dhe tjetër.

Ekipi për ndjekje të shfrytëzuesi i çmimit dorëzon njoftim nga vizita e zbatuar në terren. Në rast të parregullsive të konstatuara, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të marrë masa në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara në njoftimin.

Obligimi i shfrytëzuesit të çmimit për lehtësimin e mbikëqyrjes

Shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar t'u përmbahet procedurave dhe t'i mundësojë Fondit të kryejë mbikëqyrje të lehtë mbi zbatimin e projektit.

Shfrytëzuesi i çmimit është i obliguar t'ia mundësojë Fondit ose personave të autorizuar nga Fondi në çdo kohë të kryejnë analizë të thellë të zbatimit të projektit, aktivitetet dhe rezultateve të tyre të realizuara, si dhe për të kryer revizion në projektin dhe dokumentacionin financiar në lidhje me projektin. Shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të gjitha dokumentet relevante në lidhje me projektin t'i përgatitë dhe t'i dorëzojë në Fondin me kërkesë të tij.

Ndryshimet në strukturën e pronësisë

Në rast të ndryshimit të mundshëm të strukturës dominuese të pronësisë (mbi 50.1% të pronësisë) dhe/ose ndryshimi në strukturën dominuese të pronësisë maqedonase (mbi 50.1% të pronësisë), shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të kërkojë miratimin për ndryshim nga fondi. Ky detyrim nuk vlen rast të vdekjes së pronarit / bashkëshortit dhe / ose aksionarit dhe zbatimit të procedurës së trashëgimisë.

Në lidhje me kërkesën e lartpërmendur, Fondi është i detyruar të sjellë vendim në një afat sa më të shkurtër kohor.

Në rast të ndryshimit të strukturës së pronësisë e cila nu përfaqëson ndryshim në pronësinë dominuese, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të informojë Fondin për ndryshimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e kryerje së regjistrimit të ndryshimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ta njoftojë për ndryshimin. Ky detyrim nuk vlen në rast të vdekjes së pronarit / bashkëshortit dhe / ose aksionarit dhe zbatimit të procedurës së trashëgimisë. Gjatë ndonjë ndryshimi, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të mbajë strukturën mbizotëruese të pronësisë maqedonase.

Detyrimi i shfrytëzuesit të çmimit për të kërkuar miratimin nga Fondi për ndryshimin në strukturën dominuese të pronësisë dhe / ose strukturën dominuese maqedonase të pronësisë së shfrytëzuesit të çmimit ka për qëllim të parandalojë përpjekjet e palëve të treta të vendosin kontroll mbi shfrytëzuesin e çmimit dhe zgjat deri në përmbushjen e të gjitha detyrimet ndaj Fondit në përputhje me ndarjen e çmimit.

Në rast të ndryshimit në strukturën dominuese të pronësisë (transferimi i pjesës së pronësisë dhe / ose aksioneve) pronari i ri i shfrytëzuesit të çmimit duhet t'i ndërmarrë të gjitha detyrimet ligjore dhe përgjegjësitë nga Marrëveshja për ndarjen e çmimit dhe të nënshkruajë deklaratë për vazhdimin e projektit dhe konfirmim të kornizës kohore me deklaratë për veprim ndaj detyrimeve.

Nëse gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe përderisa zgjasin detyrimet ndaj Fondit shfrytëzuesi i çmimit ndryshon strukturën dominuese të pronësisë dhe / ose strukturën dominuese të pronësisë maqedonase pa miratim paraprak nga Fondi, e transferoi shoqatën tregtare, aktivitetet dhe / ose bartë të drejtën e pronësisë së teknologjisë / produkteve / shërbimeve të krijuara gjatë projektit jashtë vendit në çfarëdo lloj mënyre, shfrytëzuesi i çmimit do të duhet të paguajë 100% të

shumës të ndarë të mjeteve. Nëse shfrytëzuesi i çmimit planifikon të mbyllë ose likuidojë shoqatat tregtare është i detyruar që paraprakisht të informojë Fondin.

Nëse gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe përderisa zgjasin detyrimet ndaj Fondit, pronari i ri i përfituesit i çmimit ndryshon strukturën dominuese të pronësisë dhe / ose strukturën dominuese të pronësisë maqedonase pa miratim paraprak nga Komisioni për Vlerësim dhe Përzgjedhje, mbyll ose likuidon ose e bartë shoqatën tregtare aktivitetet dhe / ose transferon të drejtën e pronësisë së teknologjisë / produkteve / shërbimeve të krijuara gjatë kohës së projektit jashtë vendit në çfarëdo lloj mënyrë shfrytëzuesi i ri do të duhet të paguajë 100% nga shuma e mjeteve të ndara.

Ndryshimi i statusit

Në rast të ndryshimit të mundshëm të ndarjes së statusit shfrytëzuesit të çmimit ndërlidhja ose bashkimit të shfrytëzuesit të çmimit, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të kërkojë miratimin e ndryshimit nga Fondi.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar për miratimin e ndryshimit, Fondi është i detyruar të marrë vendim në një afat sa më të shkurtër kohor.

Nëse Fondi jep pëlqim për ndryshim të statusit-ndarjes të shfrytëzuesit të çmimit, ndërlidhja ose bashkimin e shfrytëzuesit të çmimit, pronarët e rinj të shfrytëzuesit të çmimit, trashëgimtari ligjor (sipërmarrjet me të cilat shfrytëzuesi i çmimit ka krijuar një lidhje, me të cilën shfrytëzuesi i çmimit është bashkuar ose me të cilën pronari ka transferuar mjetet - sipërmarrjet e sapo themeluara ose ato ekzistuese) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas kryerjes së ndryshimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar të lidhin një aneks të marrëveshjes së ndarjes së çmimit.

Detyrimi i shfrytëzuesit të çmimit për të kërkuar miratimin nga Fondi për ndryshim të statusit të shfrytëzuesit të çmimit zgjat deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit sipas marrëveshjes së ndarjes së çmimeve.

Përderisa në periudhën zgjasin detyrimet ndaj Fondit, trashëgimtari i ri ligjor (sipërmarrjet me të cilat është i lidhur shfrytëzuesi i çmimit, me të cilat është bashkuar ose të cilët pronari i ka transferuar mjetet - sipërmarrjet e sapo themeluara ose ekzistuese), e mbylli ose likuidon ose transferon shoqatat tregtare, aktivitetet dhe / ose transferimin e pronësisë së teknologjisë / produkteve / shërbimeve të krijuara gjatë projektit jashtë vendit, në çfarëdo mënyrë duhet të paguajë 100% të shumës së mjeteve të ndara.

Për kontrollin e ndryshimeve të mundshme në strukturën dominuese të pronësisë, strukturën dominuese të pronësisë maqedonase dhe / ose ndryshimin e statusit, Fondi mund në çdo kohë të kërkojë shfrytëzuesin e çmimit të dorëzojë gjendjen aktuale rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (jo më të vjetër se 8 (tetë) ditë).

VIII. NDËRPRERJA E FINANCIMIT DHE NDËRPRERJA E MARRËVESHJES PËR NDARJEN E ÇMIMIT

Ndërprerja e Marrëveshjes

Në rast të ndërprerjes së Marrëveshjes për ndarjen e çmimit, shfrytëzuesi është i detyruar t'i kthejë pjesë ose të gjitha fondet e marra, në pajtim me kushtet e marrëveshjes.

Pagesat e shfrytëzuesit të çmimit ndaj Fondit duhet të paguhen në denarë.

Për çdo vonesë të pagesës së mjeteve për e fondeve për larjen e detyrimeve ndaj Fondit nga ana e shfrytëzuesit në afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi dërgon paralajmërim me shkrim te shfrytëzuesi i çmimit për vonesën.

Për çdo vonesë të pagesës së mjeteve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga ana e shfrytëzuesit më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, Fondi dërgon paralajmërim e dytë me shkrim te shfrytëzuesi i çmimit për vonesën.

Për çdo vonesë të pagesës së mjeteve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga ana e shfrytëzuesit të çmimit më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, Fondi ndërpret Kontratën për ndarjen e çmimit dhe shfrytëzuesi përgjigjet për detyrimet në pajtim me dispozitat e marrëveshjes.

Ndalesa i financimit

Fondi ka të drejtë të ndërpres financimin, si dhe të ndërpret Kontratën për ndarjen e shpërblimit në rast të përvetësimit dhe shkeljes së obligimeve të Marrëveshjes për ndarjen dhe / ose dispozitat e këtyre rregullave të konkurrencës dhe sfidave, në veçanti në rastet e mëposhtme:

1. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk përdor me qëllim fondet e miratuara, përfshirë rishpërndarjen e mjeteve në përqindje më të lartë se përqindja e përcaktuar e fondeve nga buxheti i përgjithshëm i projektit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Fondit;
2. Nëse shfrytëzuesi i çmimit me qëllim për të mashtruar jep të dhëna të pasakta gjatë procedurës së ndarjes së çmimit si dhe për kohëzgjatjen e Marrëveshjes për ndarjen e çmimit që kanë ndikim material në projekt;
3. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk paraqet politika dhe procedura të përshtatshme që do t'i mundësojnë Fondit të kryen mbikëqyrje dhe t'i vlerësojë e progresin e projektit;
4. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk përgatit raporte financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit në mënyrë që përkatësisht do të pasqyrojë aktivitetet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin;
5. Nëse shfrytëzuesi i çmimit me kërkesë të Fondit nuk lejon revizion nga revizori i pavarur dhe / ose një ekspert profesional për revizion i caktuar nga Fondi;
6. Nëse shfrytëzuesi i çmimit me kërkesë të Fondit nuk lejon revizion nga Fondi të kryejnë mbikëqyrje në zbatimin e projektit, aktivitetet e tij, rezultatet e realizuara, të gjitha dokumentet relevante për projektin, ose llogaritë dhe / ose të njëjtat t'i dorëzojë te Fondi me kërkesën e tij,
7. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk e njofton Fondin për çdo ndryshim të rëndësishëm me ndikim të materialit në projekt;
8. Nëse shfrytëzuesi i çmimit vepron në kundërshtim me dispozitat e Rregullores për garat dhe sfidat në lidhje me mashtrimin dhe korrupsionin;

9. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk kërkon pëlqimin për ndryshimin e statusit dhe / ose ndryshimin në strukturën dominuese të pronësisë dhe / ose strukturën dominuese të pronësisë maqedonase me qëllim që të parandalojë çfarëdo përpjekje për vendosjen kontroll nga pala e tretë mbi shfrytëzuesin e çmimit.

10. Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk përmbahet me dispozitat e Rregullores për garat dhe sfidat në lidhje me ndryshimin e statusit dhe / ose ndryshimin e strukturës së pronësisë;

11. Në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të çmimit ose ekipit për ndjekje, nëse për shkak të pengesës së pashmangshme nga aspekti teknik ose i tregut, vihen në pyetje rezultatet e ardhshme të projektit.

Vendimi për ndërprerjen e përkohshëm të financimit

Në rast të ndodhurit çfarëdo lloj nga rrethanat e lartshënuara nga këto Rregulla për çmimet dhe sfidat, Fondi mban të drejtën të miraton vendim për ndërprerje të përkohshme të financimit, dhe / ose kërkon kthim të një pjese ose në tërësi të mjeteve financiare të paguara të shfrytëzuesit të çmimit nga ai moment.

Fondi njëkohësisht me vendimin për ndërprerje të përkohshme të financimit dërgon dhe me shkrim njofton të shfrytëzuesi i çmimit, duke informuar për ndodhitë e prishjes së Marrëveshjes për ndarjen e çmimit me kërkesë të shfrytëzuesit të çmimit t'i heq ndërprerjet në afat të caktuar nga ana e Fondit.

Me kërkesë të shfrytëzuesit të çmimit, Fondi mund t'ia miratojë shfrytëzuesit të çmimit 30 (tridhjetë) ditë shtesë për heqjen e ndërprerjes.

Në rast shfrytëzuesi i çmimit t'i tejkalojë shkeljet e identifikuar, Fondi do të sjellë vendim për tërheqjen e ndërprerjes së përkohshme të financimit.

Në rast shfrytëzuesi i çmimit nuk i heq shkeljet e identifikuar në afate të verifikimeve më lart Fondi do të vendosë nëse do të vjen deri te ndërprerja e Marrëveshjes për ndarjen e çmimit.

Vendim për ndërprerjen e Marrëveshjes së ndarjes së çmimit

Në rast të ndodhjes së çfarëdo lloj prej rrethanave për prishjen e kontratës të shënuara në Rregullat për çmime dhe sfida, Fondi mban të drejtën të miratojë vendim për prishjen e Marrëveshjes për ndarjen e çmimeve dhe ose kërkon kthim të një pjese ose të plotë të mjeteve financiare të paguara për shfrytëzuesin e çmimit deri në atë moment.

Vendimi për përfundimin e Marrëveshjes për ndarjen e çmimit e mban Fondi.

Nëse Marrëveshja për ndarjen e çmimit është prishur nga çfarëdo lloj arsye e mbuluar me këto Rregulla për çmime dhe sfida, ndërsa mjetet financiare të ndara nuk janë shpenzuar, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar t'ia kthejë fondit tërë shumën e pashpenzuar të mjeteve

më së voni prej 8 (tetë) ditësh nga dita kur nga Fondi ajo është kërkuar, në kundërshtim ai bie në vonesë dhe shumës së njëjtë mund të detyrohet të paguajë kamatë ligjore ndëshkuese në

pajtueshmëri me Ligjin për marrëdhënie të detyrimeve konsideruar nga dita e vonimit, deri në pagesën përfundimtare.

Nëse për shkak të pengesës së pashmangshme nga aspekti teknik ose i tregut sjellën në pyetje rezultatet e ardhshme të projektit, nga shfrytëzuesi i çmimit do të kërkohet të dorëzojë dokumentacionin të Fondit dhe të kërkojë ndërprerjen e projektit dhe financimin. Njëpasnjëshëm, Fondi do të vërtetojë nëse ekziston justifikim të dëshimive për ekzistencën e pengesës së pashmangshme e cila i vë në pyetje rezultatet e ardhshme të projektit dhe do të sjellë vendim përkatës. Nëse Fondi vendos që janë plotësuar kushtet e shënuara si pengesë e pashmangshme, shfrytëzuesi i çmimit nuk do të jetë i detyruar t'i kthejë mjetet e ndara.

Nëse shfrytëzuesi i çmimit nuk kërkon pëlqim për ndryshimin e statusit dhe / ose ndryshimin në strukturën pronësore dominuese dhe / ose strukturën dominuese të pronësisë maqedonase me qëllim që të parandalohet çfarëdo lloj përpjekje për të vendosur kontroll të palës së tretë mbi shfrytëzuesin e çmimit dhe / ose përderisa shfrytëzuesi i çmimit nuk përmbahet me dispozitat nga Rregullat për garat dhe sfidat që u referohen ndryshimit të statusit dhe / ose strukturës së ndryshimit të pronësisë, shfrytëzuesi i çmimit është i detyruar të paguajë Fondit 100% të shumës së mjeteve të ndara.

Të gjitha pagesat duhet ti paguhen Fondit në denarë.

Në rast se Shfrytëzuesi i çmimit nuk i plotëson detyrimet prej këtyre Rregullave për garat dhe sfida, do të zbatohen mekanizmat për mbrojtje të vërtetuara me dispozitat e Marrëveshjes për ndarjen e çmimit.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtyre Rregullave ndalojnë të vlejné Rregullat për organizimin dhe zbatimin e garave dhe sfidave për inkurajimin e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë nr. 01-494 / 4 të datës 28.11.2017 dhe nr. 01-1377 / 6 të datës 06.06.2019.

Nr. _____

Shkup, 20.01.2020

Kryetari i këshillit drejtues i

Fondit të Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik